

Frashër DEMAJ

“NAÇERTANIA” - PROJEKT SERB PËR PUSHTIMIN E TOKAVE SHQIPTARE

Situata e krijuar rreth Perandorisë Osmane në fillim të viteve të ‘40-ta të shekullit XIX, i nxiti popuj dhe shtete që jetonin në fqinjësi me Perandorinë që të bënin plane për zgjerim në territoret e kontrolluara nga Stambolli. Më të zëshmit në pjesën e Gadishullit Ballkanik ishin serbët dhe grekët të cilët për arsye religjioze dhe lidhje historike kërkonin përkrahje të bazuara në interesat e përbashkëta.

Grekët dhe serbët shfaqnin prirje të frymëzuara nga ide shoviniste duke hartuar projekte konkrete për fuqizimin e shteteve të tyre dhe zgjerim territorial. Në fillim të vitit 1944 kryeministri grek, Jani Koleti, e bëri publike dhe e shpalli zyrtarisht programin e tij politik të quajtur “Megali Idea” apo Ideja e Madhe. Ky projekt u shndërrua në platformë politike që nënkuptonte ringjalljen e Perandorisë Romake të Lindjes. Në emër të “çlirimit” por me logjikën e pushtimit edhe ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë, Ilija Garashanin, shpalli një program politik të quajtur “Naçertania”- apo projekti i cili parashikonte krijimin e një platforme politike që në themel kishte formimin e një shteti me një shtrirje të gjerë duke përfshirë territoret e Serbisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës dhe veriut të Shqipërisë, Maqedonisë, Sllavonisë, Sremit, Banati, Baçka dhe pjesa më e madhe e Kroacisë.

Pretendimet e saj në territoret shqiptare, Serbia i kërkonte përmes një shtegdalje të afërt në det për të ndërtuar një rrugë tregtare, e cila do ta lidhte me portet detare më të afërta në Adriatik. Portet detare dhe rrugët tregtare sipas “Naçertanias” do ta zhvillonin ekonomikisht Serbinë e Madhe, duke e shndërruar në vendin kryesor tregtar dhe gjeostrategjik në Ballkan. Serbët e shihnin si mundësinë më të mirë një rrugë e cila çon përmes Shkodrës në Tivar dhe Ulqin. Nga këto qytete shqiptare pretendohet që të lidhet tregtia me vendet tjera përgjatë bregdetit Adriatik me krahinën e Dalmacisë dhe qytetet kryesore tregtare. Pra, “Naçertania” parashikonte që brenda kufijve të “Serbisë së Madhe” të përfshiheshin territoret shqiptare përmes të cilave

Serbia do të bëhej zot i një pjese të Adriatikut. Këtë kërkesë, Serbia e ka përsëritur edhe në konferencat e paqes si në Kongresin e Berlinit e posaçërisht në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Garashanini për të mobilizuar forcat nacionaliste serbe rreth platformës së tij deklaronte se: “Duhet të ndërtohet një plan, i cili nuk e kufizon Serbinë në kufijtë e saj aktualë, por përpiqet të përfshijë të gjithë popullin serb brenda tij”.

Në fillim të shekullit XIX, Perandoria Osmane shfaqti shenja të dobësimit dhe të pamundësisë së administrimit të territoreve që i mbante të pushtuara në pjesën evropiane të saj. Ky fakt nënkuptonte edhe rrezikun e rrënimit të një ekuilibri forcash të krijuara ndër vite nga Stambolli. Çdo ndryshim i situatës politike dhe ushtarake do të ndikonte edhe në ekuilibrin e forcave në Evropë, prandaj tendencat ballkanike vunë në lëvizje Britaninë e Madhe dhe Francën. Diplomacia britanike për shkak të interesave të saj e përkrahte ruajtjen e *status quo*-së në Ballkan. Franca gjithashtu mbronte interesat e saj, pavarësisht se ndodhej në periudhën post napolniane e dërmuar ekonomikisht dhe ushtarakisht pas rënies së Perandorisë së Bonapartit. Austria, ishte deklaruar hapur dhe kërkonte shkatërrimin e Perandorisë Osmane me qëllim që të përfitonte territorialisht. Në Prusi vazhdonin vllimet për krijimin e shtetit kombëtar gjerman, kurse Italia e copëtuar në shtete të vogla nuk kishte arritur të krijonte relevancë ndërkombëtare. Kurse Rusia doli në skenën ndërkombëtare me flamurin e “pansllavizmit” duke luajtur rolin e protektorit të interesave sllave në Ballkan dhe Evropë.

Situata e krijuar rreth Perandorisë Osmane i nxiti popujt dhe shtetet që jetonin në fqinjësi me Perandorinë që të bënin plane për zgjerim në territoret e kontrolluara nga Stambolli. Në këtë situatë rol vendimtar kishin edhe shtetet e fuqishme të cilat kërkonin realizimin e interesave të tyre politike dhe gjeostrategjike përmes aleatëve të vegjël të cilët jetonin në fqinjësi me Perandorinë Osmane. Rolin kryesor në përcaktimin e fuqisë së këtyre popujve që kishin hyrë në rrugën e konsolidimit kishte faktori socio-ekonomik, politik dhe potencialet ushtarake për luftë kundër Perandorisë.¹ Më të zëshmit në pjesën e Gadishullit Ballkanik ishin serbët dhe grekët, të cilët për arsye religjioze dhe lidhje historike kërkonin përkrahje të bazuara në interesat e përbashkëta. Grekët gjithmonë thirreshin në kontributin që kishin dhënë për civilizimin evropian, kurse serbët mbështeteshin në origjinën e përbashkët sllave dhe lidhjet historike me Rusinë nga e cila kërkonin përkrahje për luftë kundër osmanëve.

¹ The National Archives-London, më tej (TNA), FO /373/2/1, Fondi 132, Confidential, Handbooks prepared under the directions of the historical section of the Foreign Office-nr. 16.

Këta popuj kishin shfaqur pretendime të hapura, në emër të mbrojtjes së interesave të krishterëve që jetonin në Perandorinë Osmane. Mirëpo, përtej deklaramëve proteksioniste të krishterëve (kryesisht ortodoks) qëndronin plane strategjike të motivuara politikisht për shtrirjen gjeografike dhe ndikimin sllav dhe grek në dëm të gjeografisë shqiptare.²

Grekët dhe serbët shfaqen prirje të frymëzuara nga ide shoviniste duke hartuar projekte konkrete për fuqizimin e shteteve të tyre dhe zgjerim territorial. Në fillim të vitit 1944 kryeministri grek, Jani Koleti,³ e bëri publik dhe e shpalli zyrtarisht programin e tij politik të quajtur “Megali Idea” apo Ideja e Madhe. Ky projekt u shndërrua në platformë politike që nënkuptonte ringjalljen e Perandorisë Romake të Lindjes (Bizantine), duke krijuar një shtet grek, i cili do të ishte, “një botë greke që do të përfshinte kryesisht tokat e dikurshme bizantine nga deti Jon në perëndim, Azia e Vogël dhe Deti i Zi në lindje dhe nga Trakia, Maqedonia dhe Epiri në veri, në Kretë dhe Qipro në jug.”⁴

Pra, sipas Megali Ideas, Greqia e konsideronte veten trashëgimtare të Perandorisë Bizantine dhe për këtë arsye duhej të shndërrohej në një shtet të madh me kryeqytet Kostandinopojën ku do të përfshiheshin të gjithë popujt ortodoksë, grekë dhe jogrekë të Ballkanit.⁵ Platforma e “Megali Idea” u shndërrua në pikë referimi në politikën e jashtme greke pas luftës për pavarësi (1821-1828) dhe i dominoi diskutimet e brendshme në mes të kryeministrit Koletis dhe monarkut të Greqisë, Otto, duke fituar përkrahjen e gjerë edhe brenda opinionit publik grek. Këto synime shtriheshin përtej logjikës së shpërbërjes dhe shkatërrimit të Perandorisë Osmane, e cila konsiderohej prej kohësh si pushtuese e territoreve ballkanike, sepse ishin plane nacional-shoviniste të ndërtimit dhe fuqizimit të Monarkisë greke në dëm të interesave të popujve fqinjë. “Ideja e Madhe” synohej të arrihej nëpërmjet një kombinimi të mjeteve ushtarake dhe një programi të gjerë të

² Frashër Demaj, *Pozita gjeografike, politike dhe popullsia shqiptare në dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe, 1912-1918*, ASHAK, Prishtinë 2021, f. 19.

³ Ioannis Kolettis ishte politikan grek me origjinë arumune, i cili studioi në Pisa të Italisë. Ishte ministër i Marinës dhe ministër i Mbrojtjes. Në vitin 1835 u dërgua në Francë si ambasador ku krijoi lidhje me politikanë dhe intelektualë francezë. Ai u kthye në Greqi pas grushtit të shtetit që në Athinë në shtator 1843, që e detyroi mbretin Otto të miratonte Kushtetutën. Ne zgjedhjet e vitit 1844, së bashku me Andreas Metaxas, formuan qeverinë e koalicionit. Kur Metaxas dha dorëheqjen, Kolettis u bë kryeministër dhe shërbeu në këtë detyrë deri në vdekjen e tij, më 1847. Ai ishte ideator i “Megali Idea” ose “Ideja e Madhe”, e cila u bë thelbi i politikës së jashtme greke deri në fillim të shekullit XX.

⁴ www.encyclopedia.britanica.com, Greek history, Great Idea, hulumtuar në mars 2022.

⁵ *Historia e popullit shqiptar, Rilindja Kombëtare vitet '30-të shek. XIX-1912*, Tiranë 2002, f. 102.

propagandës arsimore dhe kulturore që synonte të rrënjoste ndjenjën e identitetit helen në popullsitë greke dhe ortodokse që mbetën nën sundimin osman. Për të realizuar këtë program, Universiteti i Athinës (1837) angazhoi njerëz nga të gjitha pjesët e botës greke për t’u trajnuar si studentë, kontribues dhe apostuj të helenizmit.⁶

Në emër të “çlirimit” por me logjikën e pushtimit edhe ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë, Ilija Garashanin,⁷ shpalli një program politik të quajtur “Naçertania”- apo Projekti i cili parashikonte krijimin e një platforme politike që në themel kishte formimin e një shteti me një shtrirje të gjerë duke përfshirë territoret e popujve tjerë ballkanikë. Në projektimin dhe hartimin e “Naçertanias”, rol të rëndësishëm ka luajtur migracioni polak me orientim pansllavist në krye me diplomatin Adam Çartorijski (1770-1861), i cili në Serbi kishte dërguar agjentin e tij Frantisek Zah (1807-1892), që kishte krijuar një platformë të cilën duhej t’ia paraqiste Garashaninit dhe administratës shtetërore të Serbisë.⁸ Mbi bazën e projektit të Zah, Ilija Garashanini e kishte ndërtuar platformën politike të sanksionuar në “Naçertania”.

Projekti si një dokument sekret i kohës parashikonte hegjemoninë serbe në territoret e Serbisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës dhe veriut të Shqipërisë, Maqedonisë, Sllavonisë, Sremi, Banati, Baçka dhe pjesa më e madhe e Kroacisë së sotme dhe disa territore tjera.⁹ “Naçertania” u shndërrua në platformë të politikës së jashtme të Serbisë me synime pushtuese ndaj Ballkanit dhe territoreve shqiptare në kohën kur iluminizmi evropian si koncept politik dhe kulturor gjithnjë e më shumë po avanconte idenë e krijimit të shteteve kombëtare në kontinentin evropian.¹⁰ Ky koncept nuk i favorizonte idetë e tejkaluara për krijimin e perandorive të mëdha, siç ishte Perandoria Romake e Perëndimit, Perandoria Bizantine, Perandoria e Habsburge, Perandoria Osmane etj., por në qendër të logjikës dhe mendimit politik kishte çlirimin dhe formimin e shteteve kombëtare. Koncepti i “Naçertanias” dhe Megali Idesë ishin në kundërshtim të plotë me idetë dhe

⁶ www. encyclopedia britanica.com, Greek history, Great Idea, hulumtuar në mars 2022.

⁷ Ilija Garašanin (28 janar 1812 - 22 qershor 1874) ishte një burrë shteti serb që shërbeu si ministër i Brendshëm, ministër i Jashtëm, nga viti 1843 dhe kryeministër i Serbisë midis viteve 1852 dhe 1853 dhe përsëri nga 1861 deri në 1867. Ishte konservator në politikën e brendshme. Ai besonte se burokracia ishte e vetmja mënyrë që administrata të funksiononte. Në politikën e jashtme, ai ishte burrështetasi i parë pro Jugosllavisë në mesin e serbëve. Ai besonte se një shtet i madh jugosllav duhej ta ruante pavarësinë e tij nga Rusia dhe Austria. Ai ishte një nga politikanët serbë më me ndikim të shekullit të 19-të.

⁸ Hivzi Islami, “Kosova përballë hegjemonizmit serb”, Studime shoqërore, ASHAK, Prishtinë 2020, f. 8.

⁹ Po aty, f. 7.

¹⁰ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëllimi i tretë, Tiranë 2009, f. 1803.

konceptet përparimtare evropiane mbi shtetin kombëtar dhe funksionimin e tij.

Garashanini për të mobilizuar forcat nacionaliste serbe rreth platformës së tij deklaronte se: *“Duhet të ndërtohet një plan, i cili nuk e kufizon Serbinë në kufijtë e saj aktualë, por përpiqet të përfshijë të gjithë popullin serb brenda tij”*. Sipas kësaj logjike në planin për formimin e “Serbisë së Madhe” përveç shkatërrimit të Perandorisë Osmane pretendoheshin për t’u futur brenda juridiksionit serb territore të huaja që banoheshin nga bullgarët, maqedonasit, shqiptarët, malazezët, boshnjakët, hungarezët dhe kroatët.¹¹ Pra, ishte një projeksion serb që parashikonte ripërtëritjen e Perandorisë së Stefan Dushanit dhe shtrirjen e saj gjeografike e projektonte në territoret e populluara me sllavë dhe në territoret shqiptare të cilat mbaheshin të pushtuara nga Perandoria Osmane, duke llogaritur në rezistencën e dobët të shqiptarëve dhe mosreagimin e fuqishëm të popullsisë sllave për arsye të origjinës së përbashkët. Kjo logjikë e dominimit serb mbi sllavët konsiderohej e papranueshme edhe për popujt tjerë sllavë të jugut të cilët bënin përpjekje për ndërtimin e perspektivës së tyre jashtë ndikimit dhe pushtimit nga fuqitë e kohës. Në kufijtë e kësaj perandorie të re, sipas “Naçertanies”, do të hynin edhe viset e Shqipërisë së Veriut së bashku me Kosovën dhe viset përreth, që ministri serb e pagëzoi me emrin “Serbi e Vjetër”.¹²

Kjo situatë i gjeti territoret shqiptare nën pushtimin klasik dhe sundimin e territoreve të tyre nga Stambolli që kishte nisur një varg reformash centralizuese. Në kuadrin e reformave synohej likuidimi i sistemit të timarit, njohja e pronës private, riorganizimi i sistemit administrative, ushtarak dhe i taksave me synim evropianizimin e institucioneve shtetërore, forcimin e ushtrisë dhe pushtetit qendror të Perandorisë. Reformat e nisura nga Porta e Lartë, të shpallura me dekret perandorak - Dekreti i Gjylhanesë (3 nëntor 1939), nga Mustafa Reshit pasha u quajtën Tanzimat. Pavarësisht shpresave, Tanzimati nuk iu dha shqiptarëve asnjë të drejtë kombëtare, përfshirë këtu të drejtën e vetëqeverisjes, administratës shqiptare, shkollave kombëtare etj. Tanzimati shtoi pakënaqësinë e shqiptarëve, sepse rriti taksat, taksën e xhizjes për meshkujt e krishterë të moshës mbi 12 vjet, keqësoi edhe më tej gjendjen ekonomike dhe sociale, shërbimin e rëndë dhe të detyrueshëm ushtarak dhe masa tjera shtrënguese të cilat ndikuan që

¹¹ Më gjerësisht, Philip J. Cohen, *Serbia’s Secret War: Propaganda and the Deceit of History*. Texas A & M University Press, 1996.

¹² Ilija Garašanin, *Načertanije, Program spoljašne i nacionalne politike Srbije na koncu 1844 godine*.

https://www.rastko.rs/istorija/garasanin_nacertanije.html, hulumtuar në prill 2022.

shqiptarët të organizojnë lëvizje kryengritëse kundër autoriteteve osmane. Në fillim këto kryengritje ishin me karakter socio-ekonomik por me kalimin e kohës u pasuan edhe me kërkesa autonomiste dhe kombëtare.

“Naçertania” në vend të parimit të kombësisë, propagandonte idenë e shtetit të madh serb të bazuar në të ashtuquajturën “e drejtë shtetërore historike” sipas së cilës kërkohej që shteti serb të bëhej trashëgimtar i Perandorisë mesjetare të Stefan Dushanit.¹³ Sipas “Naçertanias”, Serbia duhet të gjej vendin e saj në radhën e shteteve evropiane duke hartuar një plan për të ardhmen e saj mbi një politikë, parimet e së cilës do të mbështeteshin në fuqinë, rolin dhe ndikimin shtetit serb.¹⁴ Sipas elitës politike serbe, Serbia është një shtet i vogël dhe nuk mund të mbetet i tillë, por duhet të synojë t’i afrojë dhe t’i bashkojë të gjithë serbët që e rrethojnë dhe duhet të marrë përsipër detyrën që i takon.¹⁵

Sa i takon qëndrimit definitiv ndaj Perandorisë Osmane, politika serbe mendonte se ky shtet duhet të shkatërrohet në një proces të rrënimit që së pari duhet ta ndajë Perandorinë, ta shkatërrojë dhe të rindërtohet nga e para nga banorët e saj të krishterë. Serbët ishin të vetëdijshëm se nuk mund ta shkatërronin Perandorinë Osmane, por shpresat e tyre ishin të varura te Perandoria Ruse dhe ajo Austriake të cilat ishin fuqitë kryesore në fqinjësi me osmanët. Sipas “Naçertanias”, këto dy fuqi mund të merreshin vesh lehtësisht në mes veti për vendet dhe krahinat që do t’i takonin njëres dhe tjetrës. Austria mund të synonte bashkimin e territoreve perëndimore, kurse Rusia, pushtimin e pjesëve lindore të Ballkanit, përfshirë këtu edhe pushtimin e Stambollit që ishte synim i Rusisë që nga koha e Petrit të Madh.

Pra, Serbia synonte të shfrytëzonte logjikën e origjinës sllave të përkthyer në aleancë politike që nënkuptonte një bashkim forcash dhe përkrahje ushtarake ruse në kuadrin e interesave të përbashkëta që do të rezultonin me krijimin e Serbisë së Madhe. Ilija Garashanin, e shikonte Austrinë si mekanizëm përmes të cilit do të lehtësohej shkatërrimi i Perandorisë Osmane, por edhe si rrezik për interesat serbe dhe zgjerimin e territoreve të tyre në Ballkan. “Naçertania” tejkalonte pretendimet për një principatë serbe me shtrirje brenda kufijve etnikë të saj. Ajo kishte në themel, Mbretërinë serbe të shekullit XIII-XIV duke synuar ripërtëritjen e lavdisë së saj dhe në tokat e dikurshme të Perandorisë Romake të Lindjes-

¹³ Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vëllimi i tretë, Tiranë 2009, f. 1803.

¹⁴ Hivzi Islami, *Demografia e Kosovës*, Prishtinë 2021, f. 526.

¹⁵ Dragosllav Stranjaković, *Kako je postalo Garašaninovo "Načertanije"*, Spomenik SKA, XCI, Beograd 1939, str. 76-102); Dragosllav Stranjaković, *Srbija, privlacno srediste jugoslovena (1844-1848)*, Beograd 1940; Dragosllav Stranjaković, *Ilija Garasanin*, Izdavač: Izdavačko preduzeće Jefimija - Kragujevac, Kragujevac 2005; Dragosllav Stranjaković, *Srbija od 1843 do 1858 godine*, Beograd 1937.

Bizantit të ndërtonte një perandori të fuqishme sllavo-serbe.¹⁶ Ngritja e Mbretërisë serbe sipas projektit, mbështetet në folklor dhe bazë shoviniste të dominimit dhe pushtimit të territoreve të huaja, të cilat në vazhdimësi do të popullohen kryesisht me sllavë të jugut ku do të dominonin serbët. Kjo tendencë e publikuar si konstruksion nationalist do të cenonte rënd interesat e shqiptarëve të cilët pas përpjekjeve të pashallëqeve të tyre për të krijuar një lloj autonomie nga Perandoria Osmane kishin hyrë në një fazë të reagimit dhe organizimit të kryengritjeve për shkak të mohimit të tyre dhe taksimit të rëndë që u bënte Perandoria Osmane në kuadrin e reformave të Tanzimatit. Pra, shqiptarët ndodheshin midis pretendimeve të tyre autonomiste, sundimit dhe shfrytëzimit nga ana e Stambollit dhe synimeve serbe, greke dhe malazeze për pushtimin e tokave të tyre.

Garashanini konsideronte se ndër të gjithë sllavët e Perandorisë Osmane, serbët janë të parët që kanë luftuar për lirinë e tyre dhe kanë të drejtë të jenë popull udhëheqës i një shteti të madh, të përbashkët sllav me shtrirje të gjerë territoriale. Ai mendonte se shteti i ri serb në jug do t'i jepte Evropës garancione të plota për një shtet që do të mund të mbahej i fuqishëm në mes të interesave të Austrisë dhe të Rusisë. Sipas kësaj logjike, fuqia e shtetit serb do të mbështetej mbi hapësirën e madhe gjeografike, pozitën gjeostrategjike, begatitë dhe pasuritë natyrore, shpirtit luftarak të popullsisë, prejardhjes së njëjtë, gjuhës së përbashkët dhe faktorëve tjerë determinues që ndikojnë në fuqinë e një shteti.¹⁷

Një nga faktorët e rëndësishëm që në kuadër të projektit u trajtua si parakusht për të realizuar pretendimet serbe ishte informacioni mbi gjendjen e popujve fqinjë që pretendoheshin për t'u përfshirë brenda kufijve të shtetit "të madh serb". Për këtë qëllim duhej angazhuar njerëz të ditur dhe të besueshëm, të cilët do të informojnë mbi gjendjen e konstatuar. Para se të dërgoheshin në terren ata duhej të merrnin instruksione mbi fushën dhe veprimtarinë që do të mbulonin në kuadrin e misionit të tyre. Synimet serbe ishin që të merreshin informata për situatën në Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi, Shqipërinë e Veriut, Sllavoninë, Dalmacinë, Sremin, Baçken dhe Banatin. Personat e rekrutuar kishin për detyrë që: të bëjnë vlerësimin e gjendjes politike, sociale, ekonomike, mbledhjen e informacioneve, takimet me njerëz të caktuar, informacione për numrin dhe fuqinë ushtarake, personalitete dashamirëse ndaj Serbisë dhe kundërshtarë të interesave të saj dhe çdo informacion tjetër që vlerësohej i dobishëm nga ana qeverisë serbe.

¹⁶ Ilija Garašanin, *Načertanije, Program spoljašne i nacionalne politike Srbije na koncu 1844 godine*.

https://www.rastko.rs/istorija/garasanin_nacertanije.html, hulumtuar në prill 2022.

¹⁷ H. Islami, *Demografia e Kosovës...*, f. 529.

Në kuadër të “Naçertanies” trajtohej gjerë e gjatë edhe pozita e bullgarëve të pushtuar nga Perandoria Osmane, që vlerësohej si një territor strategjik ku gjenden pozicionet më të rëndësishme ushtarake të forcave osmane. Sipas Garašaninit, është fat i keq se bullgarët, pavarësisht se janë dega më e madhe e popullit sllav në Turqi, nuk kanë pothuajse asnjë besim në forcat e tyre dhe vetëm stimujt e jashtëm që vijnë nga vendet e huaja (Rusia) mund t’i mobilizojnë ata që të heqin qafe sundimin osman në tokat e tyre.¹⁸

Strategjia serbe për t’i përfutur bullgarët në anën e saj mbështetej në shkollimin dhe diplomimin e klerikëve të rinj ortodoksë bullgarë në Serbi, në mënyrë që pas indoktrinimit, si priftërinj të kthehen në shërbim në vendet e tyre dhe të avokonin për Serbinë. Një formë tjetër e afrimit dhe propagandës ishte shtypja e librave kishtarë bullgarë në Serbi. Prandaj konsiderohej e nevojshme që serbë të besueshëm dhe të aftë që udhëtojnë nëpër Bullgari, të tërheqin vëmendjen e popullit bullgar në Serbi dhe do të zgjonin ndjenjat miqësore ndaj Serbisë, dhe së bashku të ringjallnin shpresën se Serbia do t’u vijë vërtet në ndihmë bullgarëve.¹⁹ Territoret e Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Shqipërisë së Veriut, sipas “Naçertanias” konsideroheshin pjesë ku Serbia mund të ketë ndikimin më të madh dhe detyra kryesore e politikës serbe në territoret osmane është ngritja e autoritetit të Serbisë në sytë e popujve të shtypur.

Politika serbe insistonte që popujt ortodoksë dhe katolikë, të kuptojnë dhe të pajtohen me njëri-tjetrin në politikën e tyre kombëtare, sepse vetëm kështu mund të ndiqet me sukses politika e përbashkimit rreth interesave reciproke. Kjo thirrje e Serbisë për unifikimin e krishterëve ortodoksë dhe katolikë do të mund të përcante mbi baza fetare popullsinë shqiptare e cila përveç shumicës islame kishte numër të konsiderueshëm të shqiptarëve katolikë dhe ortodoksë, por që jetonin në harmoni të plotë fetare pa konflikte dhe incidente të theksuara. Dallimet fetare të shqiptarët nuk shërbyen asnjëherë si shkak për të prodhuar pasoja ndërmjet tyre. Ata më tepër ishin të prirur që të afroreshin rreth kombësisë dhe gjërave tjera që i përbashkonin, si: historia, autoktonia në territoret e populluara prej tyre, gjuha, kultura, tradita, zakonet dhe elemente tjera të cilat ishin më të fuqishme se dallimet fetare.²⁰ Serbia gjithashtu kërkonte një shtegdalje të

¹⁸ Ilija Garašanin, *Načertanije, Program spoljašne i nacionalne politike Srbije na koncu 1844 godine*.

https://www.rastko.rs/istorija/garasanin_nacertanije.html, hulumtuar në prill 2022.

¹⁹ Dragosllav Stranjaković, *Kako je postalo Garašaninovo "Načertanije"*, Spomenik SKA, XCI, Beograd 1939, str. 76-102).

²⁰ TNA, FO /373/2/1, Fondi 132, Confidential, Handbooks prepared under the directions of the historical section of the Foreign Office-nr.16.

afërt në det për të ndërtuar një rrugë tregtare, e cila do ta lidhte me portet detare më të afërta në Adriatik. Portet detare dhe rrugët tregtare, sipas “Naçertanias”, do ta zhvillonin ekonomikisht Serbinë e Madhe, duke e shndërruar në vendin kryesor tregtar dhe gjeostrategjik në Ballkan. Serbët e shihnin si mundësinë më të mirë një rrugë e cila çon përmes Shkodrës në Tivar dhe Ulqin. Nga këto qytete shqiptare pretendohet që të lidhej tregtia me vendet tjera përgjatë bregdetit Adriatik me krahinën e Dalmacisë dhe qytetet kryesore tregtare. Në qytetet bregdetare shqiptare, Serbia synonte të krijonte agjenci tregtare serbe të cilat do të siguronin mbrojtjen e produkteve serbe nga konkurrenca e mallrave që vinin nga vende të ndryshme të Evropës. Agjencia do të kryente edhe misione të tjera në varësi me interesat dhe përcaktimet strategjike serbe në territoret shqiptare.

Nga pikëpamja politike, kjo masë do të ishte shumë e rëndësishme, sepse agjentët serbë do të kishin mundësi të shtonin ndikimin e Serbisë te shqiptarët e veriut dhe të Kosovës duke mundësuar që në të ardhmen pranimi i pushtetit serb me rastin e invadimit të trupave të tyre drejt tokave shqiptare të ishte më i shpejtë dhe efikas duke minimizuar edhe mundësitë e shqiptarëve për të organizuar ndonjë rezistencë serioze. Pra, “Naçertania” parashikonte që brenda kufijve të “Serbisë së Madhe” të përfshiheshin territoret shqiptare përmes të cilave Serbia do të bëhej zot i një pjese të Adriatikut. Këtë kërkesë, Serbia e ka përsëritur edhe në konferencat e paqes si në Kongresin e Berlinit e posaçërisht në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Ky projekt ekspansionist, e mohonte ekzistencën e popullit shqiptar, gjuhën, kulturën dhe traditat shqiptare të cilat nuk kishin asgjë të përbashkët me serbët dhe Serbinë. Me “Naçertanian”, Serbia e vërtetoi katërçipërisht se nacionalizmi serb nuk ishte rezultat i ideve iluministe evropiane për ndërtimin dhe emancipimin e shtetit kombëtar, por nisi dhe u zhvillua si nacional shovinizëm i bazuar në pretendimet për krijimin e Serbisë së Madhe duke synuar pushtimin e territore të huaja dhe duke nënshtruar popujt fqinjë.

Pasojat nacional-shoviniste të sanksionuara në “Naçertania” u shfaqen në fund të vitit 1877 dhe gjysmën e parë të vitit 1878, në sanxhakun e Nishit kur ushtria serbe dëboi mijëra shqiptarë nga shtëpitë e tyre. Shqiptarët e dëbuar u persekutuan, u vranë, vdiqën nga të ftohtit dhe uria si dhe u detyruan që të tërhiqen në thellësi të vilajetit të Kosovës. Pra, “Naçertania”, pavarësisht se për kohën ngeli një dokument politik sekret, megjithatë shenjat e para të realizimit të platformës së saj politike dolën sheshazi që nga Kriza Lindore e vitit 1875 e deri në përfundimin e luftërave ballkanike dhe vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913. Në vitet e Luftës së Parë Botërore dhe më vonë “Naçertania” serbe pësoi transformime në kohë dhe hapësirë, duke u pasuar me projekte tjera

nacionaliste, por asnjëherë nga tendenca për pushtimin e territoreve të huaja në Gadishullin Ballkanik.